

Bordi i Drejtorëve i KRU "Hidromorava" Sh.A. në Gjilan, në mbledhjen e dhjetë të rregullt për vitin 2025, të mbajtur më datë 31.10.2025, duke u bazuar në kompetencat e përcaktuara me nenin 21 të Ligjit Nr. 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike, si dhe nenin 13 të Ligjit Nr. 04/L-111 për ndryshimin dhe plotësimin e tij, në përputhje me nenin 26, paragrafët 1 dhe 2 të Kodit të Etikës dhe Qeverisjes Korporative për Ndërmarrjet Publike, si dhe me Statutin e KRU "Hidromorava" Sh.A., nxjerr këtë:

VENDIM

1. **Z. Albion Ramadani** emërohet në pozitën: **Zyrtar Kryesor Financiar dhe i Thesarit** në KRU "Hidromorava" Sh.A., **me mandat tre (3) vjeçar, me mundësi vazhdimi.**
2. I emëruari sipas pikës 1 të këtij Vendimi, do të fillojë punën me efekt nga data: 01.11.2025, ku do të lidhet kontrata e punësimit me përshkrimin e marrëdhënies së punës, detyrave dhe përgjegjësiive për këtë pozitë.

Arsyetim

Bordi i Drejtorëve i KRU "Hidromorava" Sh.A., ka zhvilluar procedurën e rekrutimit në bazë të Konkursit Publik nr. 894, të publikuar më datë 01.08.2025, për pozitën "Zyrtar Kryesor Financiar dhe i Thesarit" në KRU "Hidromorava" Sh.A.

Pas përfundimit të procesit të vlerësimit, Bordi i Drejtorëve, me Vendimin nr. 1294, të datës 17.09.2025, ka përzgjedhur kandidatin z. Albion Ramadani si kandidat të suksesshëm për këtë pozitë, duke përcaktuar njëkohësisht edhe të drejtën e ankesës për kandidatët e pakënaqur me rezultatin e procesit.

Me përfundimin e afatit ligjor për paraqitjen e ankesave dhe pasi nuk janë paraqitur ankesa pengesa procedurale gjatë afatit të përcaktuar ligjor, janë krijuar kushtet ligjore për emërimin e kandidatit të përzgjedhur në pozitën "Zyrtar Kryesor Financiar dhe i Thesarit" si dhe për lidhjen e kontratës së punës, në përputhje me përshkrimin e detyrave të punës për këtë pozitë.

Andaj, Bordi i Drejtorëve, pas verifikimit të plotë të procesit dhe konstatimit të përmbylljes së suksesshme të procedurës së rekrutimit, vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

KËSHILLA JURIDIKE – Pala e pakënaqur me këtë Vendim, ka të drejtë të ushtrojë të drejtën e ankimimit në Gjykatën Themelore në Gjilan.

U.D. Kryesues i Bordit të Drejtorëve
KRU "Hidromorava" Sh.A.

Z. Habil Zeqiri



Vendimi t'i dorëzohet:

- Zyrtarit Kryesor Financiar dhe të Thesarit (të emëruarit)
- Anëtarëve të Bordit të Drejtorëve dhe Kryeshefit Ekzekutiv;
- ZBNJ dhe Arkivit; dhe
- NJPMNP.